

SFIDAT NË ADMINSTRIMIN E GJYQËSORIT



Autor: Lavdim Makshana

Redaktor: Gzim Shala

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e Institutit të Kosovës për Drejtësi - IKD dhe ajo nuk pasqyron pikëpamjet e Byrosë së Narkotikëve Ndërkombëtar dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit (INL) - Departamenti i Shtetit Amerikan dhe NED-it.


RRETH IKD

IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë.

IKD

Rr. Ilaz Agushi
Prishtinë
E: info@kli-ks.org
www.kli-ks.org

Përkrahur nga:



**National Endowment
for Democracy**
Supporting freedom around the world

Prill, 2023
Prishtinë, Republika e Kosovës

Përmbajtja

1. Përmbledhja ekzekutive	4
2. Miratimi i legjislacionit sekondar	5
3. Llogaridhënia në sistemin gjyqësor dhe mekanizmat e kontrollit	6
4. Transparenca e KGJK-së dhe sistemit gjyqësor	8
4.1. (Mos) transparenca e KGJK-së përmes takimeve elektronike	9
5. (Mos) realizimi i Planit Vjetor të Punës	10
6. Zgjedhja e anëtarëve të rinjë dhe kryetarëve të gjykatave	11
7. Disiplinimi i “ <i>mëshirshëm</i> ” i gjyqtarëve	12
7.1. Amnistimi i kundërligjshëm i gjuhës seksiste në vendimin e Gjykatës Themelore të Gjilanit	12
7.2. Gjykatësi “ <i>Pishmanli</i> ” që u lirua nga përgjegjësia disiplinore	13
8. (Këq) Reagimi i KGJK-së ndaj vendimit të Qeverisë për ulje të pagave	14
9. Sfidat buxhetore të KGJK	15
9.1. Mos themelimi i degëve të reja të gjykatave	16
9.2. Mungesa e bashkëpunëtorëve profesional	16
9.3. Funkcionimi i cunguar i Gjykatës Komerciale si pasojë e buxhetit të ulët	18
10. (Pa) Barazia Gjinore në KGJK dhe Gjykata	18

1. Përmbledhja ekzekutive

Në krahasim me dy vitet paraprake, KGJK ka shënuar progres të theksuar në miratimin e akteve nënligjore. Ndonëse, KGJK ka shënuar rekord në krahasim me dy vitet paraprake në miratimin e akteve nënligjore, ky institucion sërish nuk ka arritur që të miratojë të gjitha aktet normative të parapara me Planin e Punës si dhe ato që rrjedhin si obligim nga Ligji për KGJK dhe Ligji për Gjykatat. Ndërsa, sa i përket draftimit të legjislacionit sekondar, është për t'u vlerësuar vazhdimi i praktikës pozitive të aplikuar nga KGJK për përfshirjen e publikut në fazën e draftimit të akteve normative. Në raportet paraprake, IKD kishte rekomanduar formalizimin e kësaj praktike me akt nënligjor.

Sa i përket llogaridhënies nga 17 vendime disiplinore, masa më e rëndë e shqiptuar është degradimi dhe transferimi i përhershëm i dy gjyqtarëve. Gjatë vitit 2022, kryetarët e gjykatave kanë dorëzuar raportet me shkrim dhe të njëjtit janë ftuar të raportojnë para anëtareve të Këshillit. Po ashtu, KGJK ka përmbushur mbi 98% të obligimit ligjor për vlerësimin e performancës së gjyqtarëve.

Trajtimi i kërkesave për qasje në dokumente publike mbetet një nga problemet më të mëdha të KGJK-së dhe Gjykatave në rrugën drejt avancimit të transparencës. Nga 417 kërkesa për informata dhe qasje në dokumente publike të adresuara nga IKD janë pranuar vetëm 223 përgjigje pozitive. KGJK në këtë drejtim ka bërë miratimin e një rregullore për trajtimin e kërkesave për qasje në dokumente publike, por sipas IKD-së e njëjta është jo adekuate, për arsye se shumica dërmuese e kësaj rregullore është përshkrim i dispozitave të Ligjit NR. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike. KGJK edhe gjatë këtij viti ka vazhduar praktikën e mirë të publikimit të vendimeve. Një praktikë negative që ka vazhduar edhe gjatë vitit 2022, ka qenë mbajtja e tetë (8) takimeve përmes komunikimit elektronik me e-mail dhe në asnjërin prej tyre nuk ishte bërë publik rendi i ditës e as nuk ishte lëshuar komunikatë për media.


KGJK gjatë vitit 2022 ka arritur ti përmbyll proceset e zgjedhjes së kryetarit të Gjykatës Themelore në Prizren dhe Gjykatës e Apelit, procese këto që ishin tejzgjatur. Me këtë rast, IKD tërheq vëmendjen mbi domosdoshmërinë që Këshilli në kontinuitet të kujdeset që këto pozita në asnjë rast të mos mbeten të lira, por se të plotësohen brenda afateve ligjore.

KGJK përmes lirimit nga përgjegjësia disiplinore të trupit gjykues ka amnistuar gjuhën seksiste të përdorur në aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjilan. Po ashtu, mos reagimi i Këshillit dhe mos shqiptimi i një sanksioni disiplinor ndaj gjykatësit Eroll Gashi jep një sinjal negativ mbi mënyrën e funksionimit të mekanizmave të brendshëm të këtij institucioni.

Mungesa e theksuar e buxhetit ishte reflektuar në mos realizimin e obligimeve të caktuara ligjore, konkretisht në mos themelimin e degëve të reja të gjykatave, mos përmbushjen e obligimit që çdo gjykatës të ketë nga një (1) bashkëpunëtorë profesional dhe me mos ofrimin e kapaciteteve të plota për Gjykatën Komerciale e të tjera nevoja të sistemit gjyqësor.

2. Miratimi i legjislacionit sekondar

Miratimi i akteve nënligjore është një prej detyrave dhe përgjegjësiwe më të rëndësishme të KGJK-së për të siguruar funksionimin e papenguar të këtij institucioni. Gjatë vitit 2022 KGJK ka miratuar 13 rregullore¹ dhe ka bërë dy plotësim/ndryshime të dy rregulloreve bazë². Po ashtu, KGJK ka miratuar edhe katër udhëzues³ dhe ka bërë një plotësim/ndryshim të një udhëzimit administrativ⁴. Kështu, në krahasim me dy vitet paraprake, KGJK ka shënuar progres të theksuar në miratimin e akteve nënligjore. (Shih grafikun nr.1).



Grafiku 1: Miratimi i akteve nënligjore nga KGJK 2020-2022

Ndonëse, KGJK ka shënuar rekord gjatë vitit 2022 krahasuar me dy vitet paraprake në miratimin e akteve nënligjore, ky institucion nuk ka arritur që të miratojë të gjitha aktet normative të parapara me Planin e Punës për vitin 2022, si Rregulloren për trajtimin e kërkesave për qasje në dokumente publike dhe klasifikim të dokumenteve, Planin e Veprimit për Zvogëlimin e Lëndëve Civile⁵, Rregulloren për Normën e gjyqtarëve individual, Miratimin e plotësim/ndryshimit të Rregullores për përdorimin e SMIL-it dhe Rregulloren për procedurën e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve. Shkaqe për mos realizmin e objektivave të parashikuara në

¹ Rregullorja Nr.01/2022, Nr.03/2022, Nr.04/2022, Nr.06/2022, Nr.07/2022, Nr.08/2022, Nr.09/2022, Nr.10/2022, Nr.11/2022, Nr.12/2022, Nr.13/2022, Nr.14/2022 si dhe Rregulloren për të drejtat, detyrimet, performancën, disiplinimin dhe transferimin e bashkëpunëtorëve profesional.

² Shënim: Me 24 qershor 2022 KGJK kishte bërë plotësim/ndryshimin e Rregullores Për Organizimin dhe Funksionimin e Asamblesë së Kryetarëve të Gjykatave dhe Gjyqtareve Mbikëqyrës si dhe Rregulloren Nr.02/2022.

³ Shënim: Udhëzues themelor referimit për trupat para hetuese dhe hetuese, Udhëzuesi për transferimin e lëndëve në Gjykatën Komerciale, Udhëzues për procedurën e dërgimit të shkresave nga Gjykata dhe Udhëzues për Hartimin dhe Konsultimin Publik të Akteve Normative të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

⁴ Shënim: Udhëzim Administrativ Nr.01/2022 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 011/2021 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Udhëzimit Administrativ 04/2019 për Publikimin e Aktgjykimeve të Përpunuara.

⁵ Sipas KGJK-së ky akt është incorporuar në kuadër të Planit Strategjik për Përmirësimin e Qasjes në Drejtësi (2022-2025), Efikasiteti dhe Prioritizimi i Lëndëve Brenda Sistemit Gjyqësor.

planin e punës, sipas KGJK-së kanë qenë kërkesat që kanë derivuar nga legjislacioni, përkatësisht Ligji për Gjykatën Komerciale dhe vendimet e Këshillit.⁶

Gjithashtu, as gjatë vitit 2022, KGJK nuk ka arritur që të miratojë të gjitha aktet nënligjore që ka obligim sipas Ligjit Nr. 06/L-055 për KGJK-në dhe Ligjit Nr. 06/L - 054 për Gjykatat⁷. Përveç, Rregullores për SKGJK dhe Rregullores për Administratorë të Gjykatave, KGJK gjatë vitit 2022 nuk ka miratuar rregulloret tjera që derivojnë si obligime nga dy ligjet e lartcekura.⁸ Në një përgjigje për IKD, KGJK ka theksuar se Këshilli ka miratuar të gjitha aktet nënligjore të cilat dalin si obligim ligjor, përkundër se në raportin analitik *“Administrimi i Drejtësisë nga Këshillat”*, KGJK kishte dhënë disa arsye se pse nuk i kishte miratuar këto rregullore gjatë viteve të kaluara.⁹

Lidhur me këtë, IKD rikujton sërish se rregulloret që citon KGJK janë nxjerrë në bazë të një ligji tashmë të shfuqizuar. Pra, ajo bazë ligjore tashmë nuk ekziston. Sipas nenit 42.3 të i Ligjit Nr.06/L055 për KGJK-në përcaktohet qartë se *“Deri në miratimin e akteve nënligjore të përcaktuara me këtë Ligj, të gjitha aktet nënligjore të nxjerra nga Këshilli vazhdojnë të zbatohen me kusht që të mos jenë në kundërshtim me dispozitat e këtij Ligji”*, derisa paragrafi 1 i po këtij neni përcakton se *“Aktet nënligjore të përcaktuara në këtë Ligj do të nxirren në afat prej një (1) viti pas hyrjes në fuqi të këtij Ligji”*. Pra, sipas ligjit të ri për KGJK-në, rregulloret që përmend Këshilli duhet të zbatohen vetëm deri në momentin e miratimit të akteve të tjera, të cilat sipas ligjit, duhet të miratohen në periudhë kohore prej një (1) viti që nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Sa i përket draftimit të legjislacionit sekondar, është për t’u vlerësuar vazhdimi i praktikës pozitive të aplikuar nga KGJK për përfshirjen e publikut në fazën e draftimit të akteve normative. Në raportet paraprake, IKD kishte rekomanduar formalizimin e kësaj praktike me akt nënligjor. Në këtë drejtim, KGJK tanimë ka miratuar Udhëzuesin për hartimin dhe konsultimin publik të akteve normative të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

3. Llogaridhënia në sistemin gjyqësor dhe mekanizmat e kontrollit

Gjatë vitit 2022, KGJK ka pranuar 24 kërkesa për fillimin e procedurave disiplinore nga Autoritetet Kompetente. Nga këto kërkesa KGJK ka themeluar 23 Panele Hetimore dhe ka marrë 17 vendime disiplinore, prej nga masa më e rëndë e shqiptuar është degradimi dhe transferimi i përhershëm i dy gjyqtarëve, derisa në shtatë (7) vendime gjykatësit nuk janë gjetur

⁶ Komentet e KGJK-së lidhur me këtë Raport. 6 prill 2023.

⁷ **Shënim:** Me Ligjin për KGJK dhe Ligjin për Gjykatat parashihej që deri në janar të vitit 2020 të miratoheshin këto akte normative: Kodi i Etikës për Gjyqtarë Porotë, Kodi i Etikës për Staf Administrativ, Rregullorja për Detyrat dhe Përgjegjësitë e Komisioneve të Përhershme të KGJK-së (Neni 16.4. i Ligjit për KGJK), Rregullorja për strukturën organizative dhe Funksionimin e SKGJK-së, Rregullorja për Administratorët e Gjykatave; Rregullorja për Shqyrtimin e Kërkesave për Themelimin e Degëve të Reja të Gjykatave; Rregullorja për Veprimtaritë Profesionale të Gjyqtarëve dhe Rregulloren për Arsimimin e Vazhdueshëm ligjor.

⁸ **Shënim:** Në komentet e dhëna për këtë raport (6 prill 2023), KGJK ka thënë se për shkak të prioriteteve dhe arsyeve të Komisioni për Çështje Normative nuk ka mundur ti përfshijnë në planin e punës të gjitha aktet nënligjore që burojnë nga Ligji për KGJK dhe Ligji për gjykatat, por se i ka parasysh gjatë kohës në vijim.

⁹ Makshana, L; Thaqi, M: *“Administrimi i sistemit të drejtësisë nga Këshillat”*, Prishtinë. Qershor 2022. Fq. 6-7.

përgjegjës nga KGJK për shkelje disiplinore.¹⁰ Në një (1) rast ishte hudhur poshtë raporti i Panelit Hetimor për shkak të parashkrimit absolut të pretendimit për shkelje disiplinore të Autoritetit Kompetent.¹¹

KGJK dhe Sekretariati gjatë vitit 2022 kanë përmbushur me sukses obligimin për publikimin e raportit vjetor për vitin 2021, Raportin Statistikor të Gjykatave për vitin 2022 si dhe Raportin Statistikor të Gjykatave për tre mujorin e parë, gjashtëmujorin e parë dhe nëntë mujorin e vitit 2022. Vlen të ritheksohet sërish se IKD edhe në raportet e kaluara vjetore të monitorimit të KGJK-së kishte theksuar se këto raporte statistikore përpos të dhënave statistikore nuk ofrojnë të dhëna të detajuara dhe mungon edhe qasja analitike dhe krahasuese.¹² Kjo qasje është ndjekur gjatë vitit 2022.

Bazuar në Ligjin nr. 06/L-054 për Gjykatat, kryetarët e gjykatave në baza vjetore i dërgojnë Këshillit një raport mbi suksesin e zbatimit të planit të mëparshëm vjetor për menaxhimin e lëndëve¹³ si dhe dërgojnë raporte tre (3) mujore me shkrim në Këshill.¹⁴ Në këtë drejtim kryetarët e gjykatave kanë dorëzuar raportet me shkrim dhe të njëjtit janë ftuar të raportojnë para anëtarëve të Këshillit.

Në krahasim me vitin 2021, KGJK ka përmbushur mbi 98% të obligimit ligjor për vlerësimin e performancës së gjyqtarëve. Sipas KGJK-së vlerësimi performancës vetëm për dy (2) gjykatës nuk ka përfunduar për shkak se të njëjtit kanë qenë në pushim dhe nuk ka mundur të realizohet monitorimi i seancave gjyqësore si një nga kriteret e parapara për vlerësim.¹⁵

Vendimi i KGJK-së për themelimin e Komisionit për monitorimin, vlerësimin dhe raportimin e Planit Strategjik për Përmirësimin e Qasjes në Drejtësi 2022 - 2025, si dhe Planin Strategjik për zgjidhjen efikase të lëndëve të korrupsionit dhe krimit të organizuar 2022 – 2024¹⁶, është një nga vendimet më pozitive që ka marrë KGJK gjatë viteve të fundit. Përkundër që gjatë vitit 2022 këto plane nuk kanë gjetur zbatimin e duhur,¹⁷ KGJK duhet të kujdeset që gjatë vitit 2023 ky mekanizëm i kontrollit të funksionojë dhe raportimi i komisionit para KGJK-së të bëhet brenda afateve të përcaktuara kohore¹⁸. Nevoja për monitorim të këtyre strategjive është theksuar edhe në Raportin e Progresit për vitin 2022.¹⁹

¹⁰ Përgjigje nga KGJK për IKD. 12 janar 2023.

¹¹ Vendimi **KGJK. Nr. 160/2022**.

¹² Makshana, L; Thaqi, M: “*Administrimi i sistemit të drejtësisë nga Këshillat*”, Prishtinë. Qershor 2022

¹³ **Shënim:** Në nenin 14.2.4 thuhet se: “*Kryetari i gjykatës në baza vjetore i dërgon Këshillit një raport mbi suksesin e zbatimit të planit të mëparshëm vjetor për menaxhimin e lëndëve*”.

¹⁴ **Shënim:** Sipas nenit 14.2.5 Kryetari i gjykatës i dërgon Këshillit raport tremujor me shkrim, që adreson punën e gjykatës, identifikon çfarëdo probleme me të cilat ballafaqohet gjykata, si dhe propozon hapa riparues për të adresuar problemet e identifikuara.

¹⁵ Përgjigje e KGJK-së për IKD me 4 janar 2022.

¹⁶ Vendimi KGJK.nr.397/2022. 20 tetor 2022.

¹⁷ “*Nuk ka gjetur zbatim të plotë Plani për zgjidhjen efikase të lëndëve të korrupsionit dhe krimit të organizuar*”. Betimi për Drejtësi. 2 shkurt 2023. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/nuk-ka-gjetur-zbatim-te-plotë-plani-per-zgjidhjen-efikase-te-lendeve-te-korrupsionit-dhe-krimit-te-organizuar/>). (Qasur për herë të fundit më 22 mars 2023).

¹⁸ **Shënim:** Sipas vendimit të KGJK-së, Raportimi lidhur me strategjitë do të bëhet çdo tre (3) muaj, në Këshill.


¹⁹ **Shënim:** Sipas Raportit të Progresit: “*Gjatë periudhës raportuese, Këshilli Gjyqësor miratoi planin strategjik për zgjidhjen efikase të rasteve të korrupsionit dhe krimit të organizuar, një strategji komunikimi për 2022-2024*”.

4. Transparenca e KGJK-së dhe sistemit gjyqësor

Duke marrë parasysh nivelin e ulët të besimit të publikut në sistemin gjyqësor, qasja në informacione publike në kuadër të sistemit gjyqësor përbën një çështje mjaft të rëndësishme dhe është një nga treguesit e nivelit të transparencës dhe llogaridhënies kundrejt qytetarëve, shoqërisë civile dhe mediave. Përkundër që nga viti në vit në sistemin gjyqësor ka një progres sa i përket transparencës, megjithatë kjo fushë lë ende për të dëshiruar. Problemet kryesore evidentohen në trajtimin e kërkesave për qasje në dokumente publike.

Në këtë drejtim, nga 417 kërkesa për informata dhe qasje në dokumente publike të adresuara nga IKD në KGJK dhe gjykatat në Kosovë, janë pranuar 223 përgjigje pozitive apo rreth 54%, 31 përgjigje negative dhe 163 kërkesa kanë mbetur pa përgjigje. Vetëm në KGJK, IKD gjatë kësaj periudhe ka parashtruar 59 kërkesa të tilla, nga të cilat, në 23 raste (40%) ka pranuar përgjigje pozitive, në 3 raste (5%) negative dhe 33 kërkesa (55%) kanë mbetur pa përgjigje²⁰.

Problematika e trajtimit të kërkesave për qasje në dokumente publike është një nga ngecjet më të mëdha të KGJK-së në avancimin e transparencës së gjyqësorit. KGJK ka filluar miratimin e një rregullore për trajtimin e kërkesave për qasje në dokumente publike, mirëpo ajo Draft Rregullore ashtu siç është dërguar për konsultim publik sipas IKD-së është jo adekuate, për arsye se shumica dërmuese e kësaj rregullore është përshkrim i dispozitave të Ligjit NR. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike. Nevoja për klasifikim të dokumenteve, rritja e komunikimit të brendshëm sa i përket lejimit të qasjes në dokumente publike janë çështje urgjente dhe shumë të rëndësishme që duhet të adresohen nga KGJK në mënyrë që trajtimi i kërkesave për qasje në dokumente publike të bëhet në mënyrë efektive dhe pa pengesa.




Grafiku 2: Transparenca e KGJK-së dhe gjykatave në kërkesat e IKD gjatë vitit 2022-së

si dhe planin strategjik për qasje në drejtësi për 2022-2025. Megjithatë, këto plane nuk përmbajnë gjithmonë lidhje të qarta me strategjitë përkatëse. Zbatimi i strategjive duhet të monitorohet në mënyrë efektive”.

²⁰ **Shënim:** Sipas të dhënave të Zyrës për Informim të KGJK-së janë të evidentuara 25 kërkesa pa përgjigje për IKD. Lidhur me këtë, IKD thekson faktin se jo të gjitha kërkesat janë drejtuar tek kjo zyrë pasi në mesin e këtyre kërkesave për informata ka pasur prej tyre që janë dërguar personave të caktuar zyrtarë brenda KGJK-së të cilët janë përgjegjës për fusha të ndryshme brenda këtij institucioni, por që nga të njëjtit nuk janë pranuar përgjigje.

Nga 40 takime të mbajtura nga Këshilli²¹, janë nxjerrë 523 vendime, ndërsa janë publikuar 473 sosh, përfshirë edhe ato disiplinore, apo 90%.²² Përmes një përgjigje KGJK ka treguar se se disa nga vendimet të cilat nuk janë publikuar kanë të bëjnë me çështjet disiplinore dhe disa të tjera janë në fazën e publikimit.²³ KGJK ka vazhduar t'i publikojë vendimet e saj edhe në gjuhën serbe, por se ende mbesin vendime të tilla të cilat nuk janë publikuar edhe në gjuhën serbe.²⁴



Grafiku 3: Transparenca e KGJK-së në publikimin e vendimeve gjatë vitit 2022

Në tre (3) takime të mbajtura me dyer të mbyllura vetëm në njërin prej tyre, konkretisht në takimin e 2 dhjetorit 2022, KGJK ka lëshuar komunikatë për media me çka edhe ka njoftuar publikun se çfarë është diskutuar në atë takim, ndërsa në dy (2) takime të tjera, nuk ka pasur rend të ditës e as nuk është njoftuar publiku me komunikatë për media.

Po ashtu, edhe përkundër që ekziston një dritare e veçantë për Komisionet e Përhershme të Këshillit ku parashihen të jenë të dhëna për Komisionin, anëtarët, vendimet, raportet dhe planet e punës, këto të dhëna asnjëherë nuk janë publikuar nga këto komisione, përjashtimisht të dhënave bazike për funksionin e komisionit dhe përbërjen e anëtarëve të tij. Kjo pamundëson që publiku të njoftohet lidhur me punën e këtyre komisioneve edhe përkundër që në ueb-faqen e KGJK-së figurojnë dritaret e këtyre komisioneve dhe do duhej të ishin të publikuara edhe informatat dhe të dhënat tjera.

4.1. (Mos) transparenca e KGJK-së përmes takimeve elektronike

Sipas Ligjit Nr. 06/L-055 për KGJK-në [neni 14], takimet e Këshillit janë të hapura për publikun përveç rasteve të përcaktuara në paragrafin 3 të nenit 14 të këtij ligji. Natyra publike e takimeve të Këshillit është e rregulluar edhe me Rregulloren Nr.03-2020 mbi Organizimin dhe Veprimtarinë e Këshillit Gjyqësor të Kosovës.²⁵ Në çdo rast kur Këshilli merr vendim për

²¹ **Shënim:** Sipas përgjigjes së KGJK-së për IKD, me 19 janar 2023, KGJK gjatë vitit 2022 ka mbajtur 27 takime të rregullta, 4 takime të jashtëzakonshme, 1 takim jo formal dhe 8 takime përmes e-mailit.

²² **Shënim:** Të dhënat e fundit lidhur me publikimin e vendimeve janë nxjerrë më 24 janar 2023.

²³ Përgjigje e KGJK-së për IKD. 16 shkurt 2023.

²⁴ **Shënim:** Të dhënat e fundit lidhur me publikimin e vendimeve janë nxjerrë më 24 janar 2023.

²⁵ Rregullore nr. 03-2020 mbi organizimin dhe veprimtarinë e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, neni 36.

mbylljen e takimeve, vendimi lidhur me mbylljen do të jetë publik dhe i arsyetuar, sipas ligjit në fuqi.

Ka disa vite që KGJK e vazhdon praktikën e mbajtjeve të takimeve përmes komunikimit elektronik me e-mail, për të cilat takime nuk njoftohet publiku, nuk publikohet agjenda si dhe nuk lëshohet komunikatë për media. Kjo praktikë negative paraqet mungesë të transparencës në raport me publikun. Gjatë vitit 2022, KGJK ka mbajtur tetë (8) takime të tilla. Kjo përkundër që me Ligjin për KGJK [neni 14, par 2] dhe Rregulloren mbi Organizimin dhe Veprimtarinë e Këshillit Gjyqësor të Kosovës [neni 38, par 4], rendi i ditës së Këshillit duhet të jetë publikisht i hapur së paku dyzet e tetë (48) orë para takimit.

IKD i rekomandon KGJK-së që gjatë vitit 2023 të mos e vazhdojë një praktikë të tillë, por ti ndërmarr të gjitha veprimet konkrete në mënyrë që edhe për këto takime të bëhet publik rendi i ditës sipas afatit të përcaktuar ligjor. Kjo do të ndikonte në ngritjen e transparencës dhe llogaridhënies në raport me publikun dhe do të ndalonte praktikatat negative që tanimë janë krijuar.

5. (Mos) realizimi i Planit Vjetor të Punës

KGJK me 29 dhjetor 2021 kishte miratuar planin e punës për vitin 2022. Por, disa nga objektivat të cilat Këshilli i ka paraparë në këtë plan të punës ka dështuar ti përmbush gjatë vitit të kaluar. Ndër to ka qenë edhe miratimi i tri (3) rregulloreve dhe dy (2) plotësim/ndryshimeve të rregulloreve.²⁶ Po ashtu, KGJK ka dështuar të miratojë edhe Planin e Veprimit për Zvogëlimi e Lëndëve Civile. Lidhur me këtë Plan, KGJK ka theksuar se është inkorporuar në Planin Strategjik për Përmirësimin e Qasjes në Drejtësi (2022-2025). Edhe pse i njëjtë ka qenë si akt unik në kuadër të planifikimeve të Planit të punës për vitin 2022.

Është viti i tretë radhazi që KGJK ka dështuar të miratojë Rregulloren për trajtimin e kërkesave për qasje në dokumente publike dhe klasifikimin e dokumenteve. Kujtojmë se miratimi i kësaj rregullore ka qenë e planifikuar të bëhet nga ana e Këshillit edhe në planin e punës gjatë vitit 2020 por që edhe atëherë kishte dështuar të miratohej.²⁷ Pastaj, KGJK kishte planifikuar që të njëjtën të miratojë gjatë muajve nëntor-dhjetor të vitit 2021, mirëpo e njëjta sërish nuk ishte miratuar duke u bartur për vitin pasues, e që deri më 31 dhjetor 2022 e njëjta ka dështuar të miratohet.²⁸ E njëjta gjendje është edhe sa i përket mos miratimit të Rregullores për normën e

²⁶ **Shënim:** KGJK deri me 31 dhjetor 2022 nuk ka miratuar këto rregullore të planifikuara me Plan të Punës si: **1).** Rregulloren për trajtimin e kërkesave për qasje në dokumente publike dhe klasifikim të dokumenteve, **2).** Rregulloren për Normën e Gjyqtarëve, **3).** Rregullorja për procedurën e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve. Si dhe nuk janë bërë dy (2) plotësime/ndryshime të rregulloreve të planifikuara nga KGJK si: **1).** Miratimin e plotësim/ndryshimit të Rregullores për përdorimin e SMIL-it, **2).** Hartimin e Plotësim/Ndryshimit të Rregullores për Organizimin e Brendshëm të Gjykatave për të siguruar harmonizimin e saj me Rregulloren e re për Avancim, përkritazi me kushtet që duhet plotësuar gjyqtari para avancimit/transferimit në mënyrë që të evitohet nevoja për rifillim të lëndës pas avancimit/transferimit.

²⁷ "Plani i Punës së Këshillit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2021". Fq.4,(Shih linkun: https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/reports/95135_KGJK_Plani_Punes_2021.pdf).

²⁸ **Shënim:** KGJK në fund të muajit dhjetor e ka publikuar këtë Draft Rregullore në konsultim publik, por megjithatë e njëjta sipas Planit të Punës për vitin 2022 është dashur të miratohej në tre mujorin e fundit të vitit 2022. Kjo rregullore është miratuar tek në mars të vitit 2023.

gjyqtarëve individual, pasi edhe kjo rregullore ishte vendosur në objektivat e Planit të Punës gjatë viteve 2020, 2021 dhe 2022 por që kishte dështuar të miratohej.²⁹

Pavarësisht se një numër i objektivave të KGJK-së në Planin e Punës për vitin 2022 nuk ishin përmbushur, KGJK ka arritur që brenda kësaj periudhe të realizojë një numër të madh të planifikimeve si: miratimin e tetë (8) rregulloreve dhe dy (2) udhëzuesve.³⁰

6. Zgjedhja e anëtarëve të rinjë dhe kryetarëve të gjykatave

Gjatë vitit 2022, në KGJK ishin zgjedhur edhe tre anëtar të rinj. Konkretisht nga radhët e gjyqësorit ishin zgjedhur gjyqtarët Fahret Velija dhe Nikolla Kabashiq³¹. Ndërsa, nga radhët e anëtarëve jo gjyqtarë ishte zgjedhur anëtarja Adriana Miletqi.³² Po ashtu gjatë këtij viti, KGJK ka arritur ti përmbyll proceset e zgjedhjes së kryetarit të Gjykatës Themelore në Prizren dhe Gjykatës e Apelit, procese këto që ishin tejzgjatur.³³ Po, ashtu KGJK gjatë këtij viti ka zgjedhur edhe kryetarin e Gjykatës Komerciale dhe atë të Gjykatës Themelore në Gjilan.

Pas afro dy (2) vitesh që GjTH në Prizren ishte udhëhequr me ushtrues detyre të kryetarit, KGJK më në fund gjatë vitit 2022 ka arritur të zgjedh të parin e kësaj gjykate, pasi në këtë pozitë me 5 maj 2022 është zgjedhur gjyqtarja Shpresa Emra.³⁴ Gjithashtu, KGJK me 5 maj 2022 në krye të Gjykatës së Apelit ka zgjedhur gjyqtarin Valon Totaj, zgjedhja e tij në këtë pozitë kishte ardhur pas një procesi të zgjatur për më shumë se nëntë (9) muaj³⁵. KGJK si arsye për mos përfundimin e shpejtë të këtij procesi kishte përmendur procesin e vlerësimit të performancës së kandidatëve për kryetar të Apelit të cilit i ishin nënshtruar disa prej kandidatëve.³⁶ Procesi i intervistimit të kandidatëve për këtë pozitë kishte filluar më 4 prill 2022, apo kur kishin kaluar më shumë se 9 muaj që nga shpallja e këtij konkursi.³⁷ Për dallim nga dy proceset e tej zgjatura rekrutuese të lartcekura, KGJK në afate rekorde kishte arritur të

²⁹ **Shënim:** Edhe kjo Rregullore është publikuar për komente në konsultim publik, por që deri më 31 dhjetor 2022 nuk është miratuar. E njëjta është miratuar tek në prill të vitit 2023.

³⁰“*Plani i Punës së Këshillit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2022*”. Objektiva 7. (Shih linkun: https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/reports/99914_KGJK_Plani_Punes_2022.pdf). (Qasur për herë të fundit më 12.01.2023).

³¹ **Shënim:** Nikolla Kabashiq ka dorëzuar dorëheqjen në KGJK.

³²“*Këshillit Gjyqësor të Kosovës i shtohen edhe dy anëtarë të rinj nga radhët e komunitetit serb*”. Betimi për Drejtësi”. 26 maj 2022. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/keshillit-gjyqesor-te-kosoves-i-shtohen-edhe-dy-anetare-te-rinj-nga-radhet-e-komunitetit-serb/>). (Qasur për herë të fundit më 26 janar 2023)

³³ Makshana, L; Thaqi, M: “*Administrimi i sistemit të drejtësisë nga Këshillat*”, Prishtinë. Qershor 2022. Fq. 10-11.

³⁴“*Shpresa Emra emërohet kryetare e Gjykatës Themelore në Prizren*”. Betimi për Drejtësi. 5 maj 2022. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/shpresa-emra-emerohet-kryetare-e-gjykates-themelore-ne-prizren/>). (Qasur për herë të fundit më 26 janar 2023).

³⁵“*KGJK zgjedh gjyqtarin Valon Totajn, kryetar të Gjykatës së Apelit*”. Betimi për Drejtësi. 5 maj 2022. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/kgjk-zgjedh-gjyqtarin-valon-totajn-kryetar-te-gjykates-se-apelit/>). (Qasur për herë të fundit më 26 janar 2023).

³⁶ Përgjigje nga KGJK për IKD. 22.12.2021.

³⁷ “*Një kandidat tërhiqet nga gara për kryetar të Apelit, për pesë të tjerë KGJK përfundon intervistat*”, Betimi për Drejtësi, 4 prill 2022 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/nje-kandidat-terhiqet-nga-gara-per-kryetar-te-apelit-per-pese-te-tjere-kgjk-perfundon-intervistat/>). (Qasur për herë të fundit më 26 janar 2023).

përfundonte procesin për zgjedhjen e kryetarit të GjTh në Gjilan³⁸ dhe atë të Gjykatës Komerciale³⁹.

Me këtë rast, IKD tërheq vëmendjen mbi domosdoshmërinë që Këshilli në kontinuitet të kujdeset që këto pozita në asnjë rast të mos mbeten të lira, por se të plotësohen brenda afateve ligjore.

7. Disiplinimi i “mëshirshëm” i gjyqtarëve

7.1. Amnistimi i kundërligjshëm i gjuhës seksiste në vendimin e Gjykatës Themelore të Gjilanit

Gjykata Themelore në Gjilan i kishte liruar nga akuza pesë të dyshuar për dhunimin e një 19-vjeçareje, duke përdorur gjuhë seksiste dhe arsyetim absurd. Në arsyetimin e saj, Gjykata theksonte se “viktima ka pranuar të udhëtoj me taksì me të akuzuarin, përkundër se e ka ditur se ai është i gjinisë mashkullore,” duke e cilësuar viktimën si “person me shprehi vërtetë jo të mira sidomos në aspektin moral.” Po ashtu, Gjykata kishte konstatuar se “të jesh në një hapësirë banimi me persona të ri, vetvetiu nënkupton se viktima ka qenë e pajtimit që me ta edhe të lëshohet në aventura seksuale.”⁴⁰

IKD përmes platformës “**Betimi për Drejtësi**” me 4 dhjetor 2021 kishte publikuar hulumtimin “*Seksizmi në vendimin e Gjykatës së Gjilanit*”, ku përmes këtij hulumtimi pa u lëshuar në meritat e rastit kishte treguar gjuha me të cilën ishte arsyetuar ky aktgjykim, ishte gjuhë paragjyquese, seksiste dhe ofenduese për të dëmtuarën. Lidhur me këtë rast, ish-kryetari i Gjykatës Supreme, Enver Peci kishte iniciuar në KGJK kërkesë për fillimin e hetimeve disiplinore ndaj kryetarit të trupit gjykues (*i cili e kishte përpiluar aktgjykimin*) Aziz Shaqiri dhe dy anëtarëve të trupit gjykues, Ramiz Aziqi dhe Naser Maliqi.

Por, KGJK me 28 prill 2022 kundërligjshëm e ka hedhur poshtë këtë rast, me arsyetimin se shkelja e supozuar disiplinore ka arritur parashkrimin absolut.⁴¹

IKD me 23 korrik 2022 përmes një reagimi publik e kishte quajtur të paligjshëm këtë vendim të KGJK-së. Në këtë reagim thuhej se Ligji Nr. 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve ka hyrë në fuqi më 10 janar 2019. Ky Ligj [*neni 10*] përcakton se afati i parashkrimit të shkeljes disiplinore është 5 vite. Pikërisht kjo dispozitë është dashur të aplikohet në rastin konkret, e jo dispozita që tanimë është e shfuqizuar e të cilës i referohet KGJK. Kjo pasi ky Ligj [*neni 17.4*] përcakton se “[m]e hyrjen në fuqi të këtij ligji, të gjitha ankesat lidhur me shkeljet e supozuara disiplinore, **përfshirë ato që pretendohet të jenë kryer**

³⁸“KGJK zgjedh Venhar Salihun, kryetar të Gjykatës Themelore në Gjilan”. Betimi për Drejtësi. 26 janar 2023. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/kgjk-zgjedh-venhar-salihun-kryetar-te-gjykares-themelore-ne-gjilan/>). (Qasur për herë të fundit më 26 janar 2023).

³⁹“Gjyqtari Mahir Tutuli zgjedhet kryetar i Gjykatës Komerciale”. Betimi për Drejtësi. 20 prill 2022. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/gjyqtari-mahir-tutuli-zgjedhet-kryetar-i-gjykares-komerciale/>). (Qasur për herë të fundit më 26 janar 2023).

⁴⁰“Arsyetimi seksist i vendimit të Gjykatës së Gjilanit”. Betimi për Drejtësi. 4 dhjetor 2021. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/arsyetimi-seksist-i-vendimit-te-gjykares-se-gjilanit/>). (Qasur për herë të fundit më 13 janar 2023).

⁴¹ Vendimi i KGJK-së. Nr.160/2022. 28 prill 2022.

para hyrjes në fuqi të këtij ligji, por për të cilat nuk ka filluar hetimi, para hyrjes në fuqi të këtij ligji, **do të procedohen nga autoritetet kompetente dhe këshillat, në pajtim me këtë ligj**”.⁴²

Kështu, në rastin konkret, ligji është plotësisht i qartë, se edhe në rastet kur shkeljet e supozuara disiplinore kanë ndodhur para hyrjes në fuqi të ligjit të ri por për të cilat nuk ka filluar procedura (*që është rasti konkret*) vlejné dispozitat e ligjit të ri, ku bën pjesë edhe afati i parashkrimit. Në këtë mënyrë, KGJK përmes një vendimi të tillë ka amnistuar gjuhën seksiste të përdorur në aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjilan. KGJK nuk jep ndonjë arsyetim se përse dispozita ligjore në fuqi, e cila parasheh afat pesëvjeçar të parashkrimit, nuk është zbatuar.

Ky vendim i KGJK është i kundërligjshëm, arbitrar dhe paraqet të kundërtën e llogaridhënies. E gjithë kjo përballë një qartësie të plotë të dispozitave ligjore. Kjo formë e veprimit të KGJK-së në rastin konkret paraqet dështim të mekanizmave të brendshëm të kontrollit dhe humbje të besimit të publikut në këta mekanizma. Për më tepër edhe sipas raportit të Progresit për Kosovën për vitin 2022 theksohet se edhe pse ka përpjekje për të zbatuar kornizën e duhur ligjore në lidhje me procedurat disiplinore, megjithatë nevojitet shumë vullnet, zell dhe punë për të siguruar zbatimin e qëndrueshëm dhe efektiv të procedurave disiplinore.⁴³

7.2. Gjykatësi “Pishmanli” që u lirua nga përgjegjësia disiplinore

Më 3 shkurt 2022, gjykatësi i Departamentit të Përgjithshëm të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Eroll Gashi, kishte lëshuar urdhëresë për sjellje me detyrim ndaj Xhelal Sveçlës, tani Ministër i Punëve të Brendshme, i cili kishte munguar në seancë edhe pse ishte ftuar me ftesë të rregullt. Detajet nga zhvillimi i kësaj seance gjyqësore ishin raportuar nga ana e “**Betimi për Drejtësi**”, ku ishin cituar deklaratimet e gjykatësit Gashi.⁴⁴ Pas këtij raportimi, gjykatësi i rastit ishte prononcuar në një media online duke mohuar lëshimin e kësaj urdhërese. Pas kësaj, edhe GjTh në Prishtinë përmes një reagimi kishte mohuar lëshimin e kësaj urdhërese ndaj ministrit Sveçla.⁴⁵

Në bazë të procesverbalit të seancës dhe audioincizimit të cilat edhe ishin publikuar nga “**Betimi për Drejtësi**”, kishte rezultuar se deklarimi i gjykatësit Gashi dhe komunikata e gjykatës ishin në kontradiktë të plotë me atë çfarë kishte ndodhur në seancën gjyqësore. Pasi në seancë gjyqësore, në asnjë rast nuk ishte thënë se urdhëresa për sjellje me detyrim do të

⁴² “IKD: KGJK kundërligjshëm amniston gjuhën seksiste në vendimin gjyqësor të Gjykatës Themelore në Gjilan”. Instituti i Kosovës për Drejtësi. 23 korrik 2022. (Shih linkun: <https://kli-ks.org/ikd-kgjk-kunderligjshem-amniston-gjuhen-seksiste-ne-vendimin-gjyqesor-te-gjykates-themelore-ne-gjilan/>). (Qasur për herë të fundit më 13 janar 2023).

⁴³ Raporti i Progresit për Kosovën për vitin 2022.

⁴⁴ “Urdhërohet të sjellet me forcë ministri Sveçla në rastin ku së bashku me 12 të tjerë po akuzohet për veprime të dhunshme në protestën e 2013-ës”. Betimi për Drejtësi. 3 shkurt 2022 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/urdherohet-te-sjellet-me-force-ministri-svecla-ne-rastin-ku-se-bashku-me-12-tetjere-po-akuzohet-per-veprime-te-dhunshme-ne-protesten-e-2013-es/>). (Qasur për herë të fundit më 13 janar 2023).

⁴⁵ “Gjykata Themelore në Prishtinë thotë se nuk është lëshuar urdhëresë për sjellje me detyrim ndaj ministrit Sveçla”. Betimi për Drejtësi. 3 shkurt 2022 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/gjykata-themelore-neprihtine-thote-se-nuk-eshte-leshuar-urdherese-per-sjellje-me-detyrim-ndaj-ministrit-svecla/>). (Qasur për herë të fundit më 13 janar 2023).

lëshohet vetëm nëse të pandehurit nuk paraqiten në seancën e radhës, por kjo ishte thënë vetëm në deklaratimet e gjykatësit Gashi, të publikuara në media online.⁴⁶

KGJK me vendimin e 15 korrikut 2022, kishte vendosur për lirimin nga përgjegjësia disiplinore e gjykatësit Eroll Gashi me arsyetimin se me informacionin të cilin e kishte dhënë gjykatësi Gashi për mediumin online, sipas këtij vendimi me këtë informacion nuk do të dëmtohej procesi gjyqësor.⁴⁷

Mirëpo, një vendim të tillë i KGJK-së është i pabazë përkundër fakteve dhe provave të cilat i ka administruar paneli hetimor, pasi sipas Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore, nenit 5, par 2, pika 2.10, gjyqtari konsumon shkeljen disiplinore në rastin kur: *“bën deklaratata publike gjatë procedurave që janë duke u zhvilluar e të cilat mund ose duket se ndikojnë negativisht në gjykim të drejtë dhe trajtim të barabartë të palëve në procedurë ose të cilat mund të dëmtojnë besueshmërinë dhe reputacionin e gjykatës, apo i komunikon informata publikut rreth përbërjes së paneleve gjyqësore, dëshmimeve dhe vendimeve që kanë të bëjnë me ndonjë rast, përveç nëse zbulimi i një informacioni të tillë kërkohet me ligj”*. Pra, dispozitat e Ligjit në rastin konkret janë më se të qarta dhe kjo përfordhet edhe më shumë nga fakti kur gjykatësi Gashi nuk ishte autorizuar nga kryetarja e GjTH në Prishtinë për tu deklaruar për media, mirëpo i njëjti kishte vendosur të deklarohej për media online lidhur me rastin e lartcekur. E një veprim i tillë bie në kundërshtim edhe me Kodin e Etikës profesionale për gjyqtarë, përkatësisht me nenin 6, par 2.⁴⁸

KGJK në vend që ta mbajë përgjegjës gjykatësin Gashi i cili tanimë ka humbur kredibilitetin për trajtimin e këtij rasti mediatik ku është i përfshirë një ministër, kjo e fundit e liroj të njëjtin nga përgjegjësia disiplinore. Mos reagimi i Këshillit dhe mos shqiptimi i një sanksioni disiplinor ndaj gjykatësit Gashi jep një sinjal negativ mbi mënyrën e funksionimit të mekanizmave të brendshëm.

8. (Keq) Reagimi i KGJK-së ndaj vendimit të Qeverisë për ulje të pagave

Qeveria e Republikës së Kosovës në nëntor të vitit 2022 kishte marrë vendim për uljen e pagave të gjyqtarëve dhe prokurorëve.⁴⁹ Një vendim i tillë nuk ishte mirëpritur nga Organizatat e Shoqërisë Civile. Ky vendim i tillë kishte bërë që KGJK të bojkotojë punën në gjyqësor me çka edhe ishin cenuar të drejtat e shumë qytetarëve të Republikës së Kosovës, pasi kjo e fundit nuk ka ndjekur rrugët ligjore për kundërshtimin e vendimit të Qeverisë.

⁴⁶ “Redaksia e “Betimit për Drejtësi” reagon ndaj deklaratës së pavërtetë të gjykatësit Eroll Gashi dhe Gjykatës Themelore në Prishtinë”. Betimi për Drejtësi. 3 shkurt 2022 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/redaksia-e-betimit-per-drejtesi-reagon-ndaj-deklarates-se-pavertete-te-gjykatesit-eroll-gashi-dhe-gjykates-themelore-ne-prishtine/>). (Qasur për herë të fundit më 13 janar 2023).

⁴⁷ **Shih:** Vendimin nr. 319/2022 të KGJK-së

⁴⁸ **Shënim:** Në bazë të nenit 6, par 2 të Kodit të Etikës thuhet se: *“Gjyqtari ka për detyrim që të përmbahet nga çfarëdo sqarimi për medime dhe palët tjera te interesuara lidhur me rastet konkrete përveç nëse ka autorizim për një gjë të tillë”*.

⁴⁹ Vendimi **Nr.03/109 i datës 23.11.2022.**

IKD dhe Organizatat e Shoqërisë Civile kishin reaguash për ndaj Qeverisë së Republikës së Kosovës e cila në kundërshtim me standardet kushtetuese dhe duke përdorur fakte të pavërteta kishte nxjerrë vendim për uljen e pagave të gjyqtarëve dhe prokurorëve.⁵⁰

Rruga të cilën e kishte ndjekur KGJK për të iu përgjigjur këtij vendimi të Qeverisë ishte e gabuar. KGJK me 23 nëntor kishte marr vendim me të cilin kishte kërkuar anulimin e vendimit të Qeverisë për paga dhe kishte marrë vendim për reduktim të punës në gjykata. Këshilli vendimin e Qeverisë e kishte quajtur si përpjekje për interferim në punën e sistemit gjyqësor dhe zvogëlim të pavarësisë së sistemit gjyqësor.⁵¹

Një vendim i tillë i KGJK-së kishte bërë që shumë seanca gjyqësore që ishin caktuar të anulohen.⁵² Ky dështim i seancave kishte zgjatuar deri me 3 dhjetor 2022, kjo pasi GjTh në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative kishte aprovuar masën e përkohshme të Shoqatës së Prokurorëve ndaj vendimit të qeverisë për paga.⁵³

Përballë një vendimi kundërkushtetues të Qeverisë së Republikës së Kosovës, sistemi i drejtësisë do të duhej të ishte shembull i asaj se si mbrohet një e drejtë përmes rrugës gjyqësore dhe jo të merrte veprime që shkojnë në dëm të qytetarëve të Republikës së Kosovës. Kjo mënyrë e veprimit të gjyqësorit cenon të drejtat e shumë palëve, që ndoshta kanë pritur me vite që të zgjidhen rastet e tyre.

9. Sfidat buxhetore të KGJK

KGJK në vitin 2022 kishte kërkuar një buxhet prej 38 milion e 623 mijë euro, por që pavarësisht kërkesave të KGJK-së, në fund ishte miratuar shuma prej 32 milion euro për këtë institucion.⁵⁴ Ky buxhet ka pamundësuar që ky institucion të i përmbush të gjitha obligimet e gjyqësorit, kjo

⁵⁰ “Shoqëria civile: Ulja e pagave për sistemin e drejtësisë paraqet ndërhyrje në drejtësi dhe rrit potencialin korruptiv”. Instituti i Kosovës për Drejtësi. 23 nëntor 2022. (Shih linkun: <https://kli-ks.org/shoqeria-civile-ulja-e-pagave-per-sistemin-e-drejtësisë-paraqet-nderhyrje-ne-drejtësi-dhe-rrit-potencialin-korruptiv/>). (Qasur për herë të fundit më 14 janar 2023).

⁵¹ “KGJK kërkon anulimin e vendimit të Qeverisë për pagat, merret vendim për reduktim të punës në gjykata”. Betimi për Drejtësi. 23 nëntor 2023. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/kgjk-kerkon-anulimin-e-vendimit-te-qeverise-per-pagat-merret-vendim-per-reduktim-te-punes-ne-gjykata/>). (Qasur për herë të fundit më 14 janar 2023).

⁵² “Në Gjykatën Themelore në Prishtinë dhe degët e saj sot u anuluan 113 seanca, u mbajtën 6 nga lista e shërbimeve esenciale”. Betimi për Drejtësi. 29 nëntor 2022. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/ne-gjykatën-themelore-ne-prishtinë-dhe-degët-e-saj-sot-u-anuluan-113-seanca-u-mbajten-6-nga-lista-e-shërbimeve-esenciale/>). (Qasur për herë të fundit më 14 janar 2023).

“Vendimi i KGJK-së, Gjykata e Prizrenit të mërkurën anuloi 30 seanca”. Betimi për Drejtësi. 30 nëntor 2022 (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/vendimi-i-kgjk-se-gjykata-e-prizrenit-te-merkuren-anuloi-30-seanca/>). (Qasur për herë të fundit më 14 janar 2023).

“Gjykata Komerciale anuloi 36 seanca që nga vendimi i KGJK-së për reduktim të punës”. Betimi për Drejtësi. 30 nëntor 2022. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/gjykata-komerciale-anuloi-36-seanca-qe-nga-vendimi-i-kgjk-se-per-reduktim-te-punes/>) (Qasur për herë të fundit më 14 janar 2023).

“Rreth 800 seanca të anuluar në Gjykatën Themelore në Prishtinë që nga vendimi i KGJK-së” Betimi për Drejtësi. 1 dhjetor 2022. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/rreth-800-seanca-te-anuluara-ne-gjykatën-themelore-ne-prishtinë-qe-nga-vendimi-i-kgjk-se/>). (Qasur për herë të fundit më 14 janar 2023).

⁵³ (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/gjykata-pezuillon-vendimin-e-qeverise-per-uljen-e-pagave-te-prokuroreve-dhe-gjyqtareve/>). (Qasur për herë të fundit më 14 janar 2023).

⁵⁴ **Shih:** Ligj Mbi Ndarjet Buxhetore Për Buxhetin e Republikës së Kosovës për Vitin 2022

pasi ishin aprovuar 6 milion euro më pak se sa kishte qenë kërkesa e këtij institucioni. Kjo ishte reflektuar në mos realizimin e obligimeve të caktuara ligjore, konkretisht në mos themelimin e degëve të reja të gjykatave, mos përmbushjen e obligimit që çdo gjykatës të ketë nga një (1) bashkëpunëtorë profesional dhe po ashtu me mos ofrimin e kapaciteteve të plota për Gjykatën Komerciale e të tjera nevoja të sistemit gjyqësor.

9.1. Mos themelimi i degëve të reja të gjykatave

Me Ligjin Nr. 06/L – 054 për Gjykatat, KGJK obligohej që të themelonte degët e reja të gjykatave, konkretisht degën e Fushë Kosovës, Obiliqit, Junikut, Shtimes dhe Hanit të Elezit.⁵⁵ Sipas KGJK-së, dega në Fushë Kosovë është themeluar dhe është në proces e sipër të funksionalizimit, kurse sa i përket degëve tjera, KGJK ka sqaruar se do ta procedojë këtë çështje konform mundësive buxhetore, përkatësisht ndarjes së buxhetit, si dhe duke marr parasysh ngarkesën me lëndë dhe numrin e banorëve të këtyre komunave, në bazë të regjistrimit zyrtar nga institucionet kompetente.⁵⁶

Zbatimi i këtyre dispozitave ligjore për themelimin e degëve të lartcekura ishte kërkuar edhe nga Rishikimi Funkcional i Sektorit të Zbatimit të Ligjit në Kosovë.⁵⁷ Mirëpo, hapja e këtyre degëve të gjykatave është e kushtëzuar edhe nga mjetet buxhetore që Kuvendi i Republikës së Kosovës ka alokuar në adresë të KGJK-së. Me buxhetin e vitit 2021 të aprovuar nga Kuvendi⁵⁸, ndër të tjera parashihej ndërtimi i objektit të Gjykatës në Fushë Kosovë, derisa për vitin 2022⁵⁹, krahas vazhdimit të projektit për Gjykatën në Fushë-Kosovë⁶⁰, me buxhetin e miratuar planifikohej edhe ndërtimi i objektit të Gjykatës në Shtime, por jo edhe ndërtimi i objekteve për Gjykatën e Junikut dhe Hanit të Elezit. Edhe përkundër që me buxhetin e miratuar parashihej ndërtimi i objektit të Gjykatës në Shtime, KGJK gjatë vitit 2022 nuk e ka përfunduar ndërtimin e këtij objekti.

Themelimi i degëve të reja të gjykatave është i një rëndësie të veçantë për avancimin e qasjes në drejtësi për qytetarët. Përmes themelimit të degëve të reja të gjykatave, qytetarët e kanë më të lehtë të marrin shërbime nga gjykatat derisa të njëjtat lirojnë nga puna edhe gjykatat e tjera, në të cilat qytetarët e këtyre komunave marrin shërbime. Përcaktimi me ligj i këtyre degëve të gjykatave dhe mos mbështetja e sistemit gjyqësor me buxhet për themelimin e këtyre degëve paraqet mungesë të vullnetit real për avancimin e qasjes në drejtësi për qytetarët.

9.2. Mungesa e bashkëpunëtorëve profesional

Neni 39 i Ligjit Nr. 06/L – 054 për Gjykatat, ka përcaktuar se çdo gjyqtar duhet të ketë së paku nga një bashkëpunëtor profesional, që i shërben ekskluzivisht gjyqtarit në fjalë. Për shkak të

⁵⁵ Ligji Nr. 06/L - 054 për Gjykatat, neni 10.

⁵⁶ Përgjigje nga KGJK për IKD, 19 janar 2023.

⁵⁷ **Shënim:** Sipas dokumentit “*Rritja e efikasitetit të sistemit gjyqësor dhe prokurorial*” duhet të zbatohen dispozitat ligjore për themelimin e degëve të Gjykatave Themelore në Fushë Kosovë, Junik dhe Shtime. Fq.74.

⁵⁸ Ligji nr.07/L-041 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021. Fq.115-116

⁵⁹ Ligji nr.08/L-066 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022. Fq.100-101.

⁶⁰ **Shënim:** Dokumenti “*Rritja e efikasitetit të sistemit gjyqësor dhe prokurorial*” theksonte se hapja e degës së gjykatës në Fushë Kosovë do të mbulonte rreth 57 mijë banorë. Kjo degë do të mbulonte Komunën e Fushë Kosovës dhe Obiliqit.

mungesave buxhetore, KGJK nuk ka pasur mundësi ta përmbush këtë obligim. Përmbushja e një obligimi të tillë do të ndikonte direkt në rritjen e efikasitetit në gjyqësor dhe gjithsesi kjo do të reflektohej edhe në vonesa më të vogla të zgjidhjes së lëndëve gjyqësore. Mbi të gjitha, do respektohej ligji.

Sipas KGJK-së gjatë vitit 2022 në Gjykatat e vendit kanë qenë të punësuar 277 bashkëpunëtorë profesional.⁶¹ Nëse krahasohet me numrin e gjyqtarëve, 404,⁶² atëherë i bie që 127 gjyqtarë kanë mbetur pa bashkëpunëtorë profesional. Sipas KGJK-së ky obligim nuk është realizuar si pasojë e mos ndarjeve buxhetore nga Qeveria lidhur me këto pozita.⁶³ Sipas KGJK-së nga Ministria e Financave janë kërkuar që të aprovohen 167 pozita por që sipas tyre këto pozita nuk janë aprovuar për vitin 2022. IKD gjatë draftimit të këtij raporti ka kërkuar sqarime nga Ministria e Financave se pse nuk janë aprovuar këto pozita, por se nuk ka marrë përgjigje.

Ndryshe, në Raportin e Progresit për Kosovën për vitin 2022 ndër të tjera thuhet se: “*Edhe pse numri i bashkëpunëtorëve profesional në të gjitha gjykatat e Kosovës është rritur në vitin 2021, numri i stafit ligjor që ndihmon drejtpërdrejt gjyqtarët dhe prokurorët mbetet i pamjaftueshëm. Një numër konkursesha kanë mbetur të paplotësuara pasi Kuvendi nuk miratoi kërkesën e plotë të buxhetit të gjyqësorit për vitin 2022*”.



Grafiku 4: Numri i bashkëpunëtorëve profesional në raport me numrin e gjyqtarëve gjatë vitit 2022

Parimi 7 themelor i OKB-së rreth pavarësisë së gjyqësorit përcakton s: “*Është detyrë e secilit Shtet Anëtar që të sigurojë burime të mjaftueshme për t’i mundësuar gjyqësorit që t’i kryejë funksionet e veta në mënyrë të duhur*”⁶⁴. Në këtë drejtim, përkrahja e sistemit të drejtësisë vetëm me ligje, pa ndarë buxhet adekuat për përmbushjen e këtyre ligjeve, nuk paraqet përkrahje për sistemin e drejtësisë. Andaj, është e rëndësishme që Kuvendi të ndajë buxhet adekuat për sistemin e drejtësisë, të paktën sa për të përmbushur obligimet e përcaktuara me ligjet e miratuara nga Kuvendi.

⁶¹ Përgjigje e KGJK-së për IKD. 26 janar 2023.

⁶² **Shih:** Raportin Statistikor të Gjykatave-Vjetor 2022. Fq.3.

⁶³ Përgjigje e KGJK-së për IKD. 19 janar 2023.

⁶⁴“*Parimet themelore për pavarësinë e gjyqësorit*”- (Shih linkun: https://www.icj.org/wp-content/uploads/2014/03/UN-Basic-principles-independence-judiciary-1985-eng.pdf?fbclid=IwAR0qAt0U3sObLGy1gjrxeBRc51ueNHEbMN7p-QoRzsk4oCfOnys1xq_-Lo).

9.3. Funksionimi i cunguar i Gjykatës Komerciale si pasojë e buxhetit të ulët

Ligji Nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale i cili ka hyrë në fuqi më 10 shkurt 2022 parasheh organizimin dhe funksionimin e kësaj Gjykate brenda kornizës ekzistuese të sistemit gjyqësor të Republikës së Kosovës. Sipas nenit 9 të këtij ligji, Gjykata Komerciale do të funksionojë në mënyrë të shpejtë dhe efikase për të siguruar zgjidhjen në kohë të kontesteve.⁶⁵ KGJK pas hyrjes në fuqi të këtij ligji ka qenë i obliguar të fillojë procedurat për funksionalizimin e kësaj gjykate, konkretisht me zgjedhjen e gjyqtarëve, rekrutimin e stafit mbështetës, transferimin e lëndëve dhe obligime të tjera të përcaktuara sipas Ligjit për Gjykatën Komerciale.

Mirëpo, deri më tani KGJK ka zgjedhur kryetarin e Gjykatës Komerciale, nëntë (9) gjykatës në dhomën e shkallës së parë dhe gjashtë (6) gjykatës në dhomën e shkallës së dytë të kësaj gjykate. Në KGJK thonë se nga 82 pozitat e nevojshme, janë aprovuar vetëm 50 prej tyre e që sipas tyre kjo ka ndikuar edhe në efikasitetin e kësaj gjykate.⁶⁶

Në përlogaritjen në raport me Rregulloren për caktimin e normës të punës së gjyqtarëve, i bie se me këtë numër të gjyqtarëve, dhomës së shkallës së parë të Gjykatës Komerciale i duhen 3.13 vite për të përfunduar lëndët. Kjo pa pranuar lëndë të reja. Në këtë mënyrë, nuk mund të themi se Gjykata Komerciale ka kapacitete të plota për të iu ofruar bizneseve të drejtë më cilësore dhe në kohë më të arsyeshme, që është edhe qëllimi i themelimit të saj. Kështu, vullnetit politik për avancim të drejtësisë komerciale përmes miratimit të legjislacionit, i ka munguar vullneti për të ndarë buxhet të mjaftueshëm.

10. (Pa) Barazia Gjinore në KGJK dhe Gjykata

Përfaqësimi jo i barabartë gjinor është i theksuar në sistemin gjyqësor. Nga 419 gjyqtarë sa janë aktualisht në sistemin gjyqësor, 273 janë burra apo shprehur në përqindje rreth 65% dhe 146 janë gra apo 35%. Sipas Raportit të Progresit për vitin 2022, Kosova ende ka një përqindje të ulët të gjyqtarëve dhe prokurorëve femra në krahasim me shumicën e vendeve të tjera evropiane.⁶⁷ Përqindje pothuajse e ngjashme është edhe sa i përket përbërjes së KGJK-së. Nga 11 anëtarë të Këshillit, vetëm katër (4) janë gra. Shprehur në përqindje i bie se 63.63% e KGJK përbëhet nga burrat dhe vetëm 36.36% e KGJK përbëhet nga gratë.

Pabarazia më e theksuar shprehet në pozitat udhëheqëse. Përqindja e grave në pozitat udhëheqëse nuk është ekuivalente me përqindjen e përgjithshme të grave gjyqtare në sistemin e drejtësisë. Kjo pasi nga dhjetë (10) gjykata në vend, vetëm dy (2) prej tyre (*Gjykata Themelore në Prishtinë dhe ajo në Prizren*) udhëhiqen aktualisht nga gratë.

Kështu, përballë faktit se 35% e sistemit gjyqësor përbëhet nga gratë, vetëm 20% e tyre janë në pozita udhëheqëse. (*Shih grafikën më poshtë*).

⁶⁵ Ligji Nr. 08/L-015 Për Gjykatën Komerciale, neni 9.

⁶⁶ “Veliq: Janë aprovuar 6 milionë euro më pak se që kemi kërkuar, ndikon në efikasitet”. *Betimi për Drejtësi. 7 qershor 2022*. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/veliq-jane-aprovuar-6-milione-euro-me-pak-se-qe-kemi-kerkuar-ndikon-ne-efikasitet/>). (Qasur për herë të fundit më 24 janar 2023)

⁶⁷ Raporti i Progresit për Kosovën 2022.



NGA **10** GJYKATA NË VEND:

